



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROÇEDURAVE

Nr. 720<sub>3</sub> Prot.

Tiranë, më 13.02.2025

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 06, datë 13.02.2025

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "MSE" Shpk, me NIPT L82001005A nga e drejta për të fituar kontrata publike, për paraqitje dokumentacioni me të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi në procedurën e prokurimit me objekt: "*Mirëmbajtje e pajisjeve të mëdha mjekësore të prodhuesit Philips/ose ekuivalent, prodhuesit Siemens/ose ekuivalent dhe prodhuesit Toshiba/ose ekuivalent dhe prodhues GE Healthcare/ose ekuivalent për 24 muaj*", Loti 1 me objekt: "*Mirëmbajtje e pajisjeve të mëdha mjekësore të prodhuesit Philips/ose ekuivalent*) me fond limit 88.858.534,38 lekë pa Tvsh, me Nr. REF- 85014-10-24-2023, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, në datë 30.11.2023.

**Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit, NIPT, adresa):** "MSE" Shpk, me NIPT L82001005A, me adresë: Rruga "Diga e Liqenit", Nr. Pasurie 8/312, Zona Kadastrale 8270, Tiranë.

**I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:**

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "MSE" Shpk, me NIPT L82001005A, ka nisur bazuar në shkresën datë 08.10.2024, plotësuar me shkresën datë 23.10.2024 dhe datë 13.11.2024, dërguar nga operatorit ekonomik "Health & Light".

**II. Gjetjet:**

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a të LPP, ku parashikohet se: "*Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi*".

**III. Masat:**

Me Vendimin Nr. 06, datë 13.02.2025, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "MSE" Shpk, me NIPT L82001005A, nga e drejta për të fituar kontrata publike, **për 12 (dymbëdhjetë) muaj**, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.